



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 24
Prishtinë, më 02.10.2018, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Haxhi Shala, kryetar, Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë, Zoran Mojsilović, zëvendëskryetar i dytë, Fatmir Xhelili, Ismet Beqiri, Daut Haradinaj, Bahrim Shabani, Xhelal Sveçla, Fadil Beka, anëtarë.

Munguan: Ramiz Kelmendi, Aida Dërguti

Përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme: Bejtush Gashi-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Myzejine Selmani-këshilltare e Ministrit, përfaqësuesit e Inspektoratit Policor të Kosovës-Miradije Kelmendi-Kryeshefe e IPK. Kushtrim Hodaj-zyrtar në IPK

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Drita Perezic-ICITAP, Shqipe Dërguti-ICITAP, Dhrata Kryeziu-OSBE, Leorent Alija-KDI, Betim Musliu-IKD

Nga stafi mbështetës i komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Haxhi Shala, Kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

Raportimi i Ministrit të Punëve të Brendshme z.Bejtush Gashi

Kryetari i komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

Kryetari, fillimisht theksoi se qëllimi i këtij takimi pse është ftuar Ministri i Punëve të Brendshme, është për të raportuar për gjendjen e sigurisë në vend, objektivat e Ministrisë si dhe të Policisë së Kosovës. Fjalën ia kaloi Ministrit.

Bejtush Gashi-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, theksoi se sa i përket përmbushje së obligimeve të agjencive që janë në kuadër të Ministrisë, ato i kanë përmbushur obligimet dhe janë të përgjegjshme në kryerjen e detyrave. Gjithashtu janë plotësuar edhe disa udhëzime administrative dhe janë miratuar një sërë ligjesh, siç është Ligji për të huajt, për azil, për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit si dhe rregullorja për sistematizimin vendeve të punës në kuadër të MPB-së. Gjithashtu udhëzimi administrativ për regjistrimin e automjeteve me targa KS, po ashtu janë hartuar koncept dokumentet për luftimin e krimit kibernetikë, letërnjoftimin, ndërsa janë miratuar disa strategji siç është strategjia për luftimin e terrorizmit dhe plani i veprimit, strategjia për integrimin e personave të riatdhesuar.

Gjithashtu është miratuar edhe strategjia kundër krimit të organizuar dhe narkotikëve. Në proces janë strategjitë e tjera si është strategjia për migrim, menaxhimi i integruar i kufirit dhe policisë së udhëhequr nga intelijenca. Po ashtu theksoi se është bërë përzgjedhja e drejtorit të përgjithshëm të policisë dhe Kryshefit të IPK-së, duke theksuar që janë respektuar të gjitha standardet konform ligjit, ndërsa gjetjet e auditorit do të përmbushen deri në fund të vitit. Gjithashtu nga ana e ministrisë janë zhvilluar lotime për anëtarësimin në INTERPOL. Ndërsa sa i përket obligimeve që dali nga MSA, theksoi se nga 94 kriteret, 70 prej tyre kanë qenë për MPB-në dhe janë përmbushur në tersi.

Rexhep Selimi, theksoi se nga takimi i fundit me grupin punues për mbikëqyrjen e Ligjit të IPK, ka kërkuar që në raportim të jetë Ministri, ndërsa Kryshefja nuk ka qenë e ftuar.

Daut Haradinaj, shtroi pyetjet si në vijim për Ministrin: A e keni planifikuar rregullimin e statusit juridiko financiar për Zjarrfikësit e Kosovës, në sistemin e ri të pagave, pasi janë në gjendje jo të mirë? A i keni siguruar mjetet për rritjen e pagave për policinë e Kosovës? Në cilën fazë të sigurimit të mjeteve jeni për ta draftuar ligjin për pensionimin e parakohshëm të policëve tanë?

Bejtush Gashi-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në përgjigjeje të pyetjeve të z. Haradinaj, theksoi se sa i përket ligjit për pensionimin e pjesëtarëve të policisë, ka kosto financiare dhe janë në diskutim me Fondin Monetar Ndërkombëtar, dhe nuk është vënë në diskutim për shkak të buxhetit, ndërsa sa ai përket zjarrfikësve janë në diskutim e sipër, pasi në aspektin ligjor në 2013 shërbimi i zjarrfikësve ka kaluar në kuadër të përgjegjësive të Agjencionit për Menaxhimin e Emergjencave, por në aspektin financiar ka mbet përgjegjësi e komunave, kjo pasi Ligji për menaxhimin e financave lokale, ka nevojë të ndryshohet, por është disponim i mirë që kërkesave të zjarrfikësve tu jepet zgjidhje.

Fatmir Xhelili, shtroi pyetje për Ministrin. Cilat hapa konkret janë marrë nga ju si Ministër për rregullimin e çështjes së zjarrfikësve, edhe në drejtimin juridik dhe financiar? Si është planifikuar statusi i tyre? Cili ka qenë rekomandimi i grupit punues për këtë çështje?

Bejtush Gashi-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në përgjigjeje të pyetjeve të z.Xhelili, theksoi se nga vlerësimet e brendshme dhe të jashtme ka rezultuar që shërbimi i zjarrfikësve kalo në autoritetin dhe mbikëqyrjen e nivelit qendror dhe kjo ka ardhur ri rrjedhojë e problemeve financiare që kanë komunitat. Hapat konkret janë që është nënshkruar marrëveshje me të gjitha komunitat për kalimin këtij procesi, por ka pasur problem në aspektin juridik, pasi në aspektin e financave shërbimi i zjarrfikësve mbutohet me Ligjin për financat lokale dhe kjo çështje ka mbetur e pa rregulluar, por shpejt do të aprovohet edhe kërkesa në Qeveria që për një kohë të shkurtër kjo çështje do të rregullosh. Ndërsa s ai përket ligjit për paga, theksoi çështja e zjarrfikësve ka hyrë në kategori që nuk do duhej të ishte, por Ministri ka premtuar që kjo çështje do të rregullohet, pasi shërbimi i zjarrfikësve duhet të vendoset tek strukturat reagues dhe jo shërbyese. Po ashtu paga e zjarrfikësve do të rritet.

Fatmir Xhelili, theksoi se duke qenë se Projektligji për pagat është në kuvend, kërkoi që të dërgohet kërkesë me shkrim në mënyrë që të bëhet kategorizimi adekuat për zjarrfikësit.

Rexhep Selimi, lidhur me projektligjin për pensionimin e pjesëtarëve të policisë së Kosovës, duke iu referuar përgjigjjes së Ministrin shtroi pyetjen. A do të thotë që edhe për këtë vit nuk do të procedohet projektligji në Kuvend? Cila është kostoja e buxhetit të Kosovës në rast të miratimit të këtij projektligji?

Bejtush Gashi-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, theksoi se janë marrë komentet dhe ka nevojë për konsultime shtesë por kanë mbet çështje për tu diskutuar, duke shtuar që brenda dy javëve do të jenë edhe disa diskutime dhe më pas do të procedohet. Kostoja nuk është e pa përballueshme.

Ismet Beqiri, lidhur me çështjen e zjarrfikësve, theksoi se për të qenë më funksional, ndoshta lënia e tyre në nivel komunal do të ishte me mirë, por secila zgjidhje që të bëhet duhet të bëhet në mënyrë racionale në mënyrë që ndarja e buxhetit për këtë kategori të bëhet në mënyrë të dinjitetshme.

Xhelal Sveçla, duke iu referuar deklaratës së Ministrin që situata e sigurisë është stabile. Sa i përket ngjarjeve të fundit. A ka qenë Ministri i Punëve të Brendshme i njoftuar për vizitën e Presidentit të Kosovës në veri të vendit dhe me planin operacional? A ka qenë Ministri i Punëve të Brendshme i ftuar për këtë vizitë? A konsideroni që siguria është stabile, marrë parasysh faktin që shteti serb ka ngritur masat sigurisë? Sa i përket emrave të reja në IPK, ku ish kryeshefi tashmë është pjesë e policisë, ndërsa kryeshefi i ri është emëruar, ndërsa ish drejtori i policisë, ka kaluar në strukturë tjetër të sigurisë, duke sikur një amnistim i skandaleve. A i kontribuon kjo situatë sigurisë në vend? Sa i përket sigurisë në rrugë, a është bërë takim me Ministrin e infrastrukturës për të shtuar sinjalizimin në rrugë?

Bejtush Gashi-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme theksoi se situata e përgjithshme e sigurisë është stabile si rezultat i gatishmërisë për të ju përgjigjur çdo rrethane, nga

institucionet e Kosovës. Ndërsa sa i përket vizitës së Presidentit në kuadër të Kosovës janë agjendë e tij dhe janë në autoritetin e tij, ndërsa institucionet janë të obliguara që të përmbushin obligimet për realizimin e vizitës së planifikuar. Tensionet vijnë si rezultat i raporteve që aktualisht janë, siç është çështja e dialogut. Gjithashtu janë realizuar takime me ministrin e Infrastrukturës dhe janë bërë premtime për zgjidhjen e problematikës së trafikut edhe në bashkëpunim me kompanitë që kanë kontrata deh masat e ndërmarra nga institucionet kompetente, kanë dhënë rezultate e veta.

Xhelal Sveçla, theksoi se nuk e kuptoi nëse ka qenë i njoftuar për vizitën e Presidentit dhe për planin operativ. Gjithashtu pyet, nëse e sheh si minim të rolit të tij, nëse vartësi i tij është ftuar të merr pjesë në këtë vizitë në veri të vendit?

Bejtush Gashi-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, theksoi se për aq sa është Brenda territorit Ministria ka kryer obligimin e saj, perimetritin e jashtëm e ruajnë forcat e KFOR-it, ndërsa objektet e rëndësisë së veçantë i ruan policia e Kosovës dhe nuk ka pasur ngritje të nivelit të sigurisë ashtu siç është raportuar në media.

Sveçla, theksoi se nuk morri përgjigjeje për pyetjet e shtruara?

Ministri, theksoi se nuk mund të tërhiqen paralele si në rastin deportimit të qytetarëve turq si dhe rasti i vizitës së Presidentit. Ndërsa policia e Kosovës është e gatshme 24/7 në shërbim të qytetarëve të saj dhe për sigurinë në vend.

Zoran Mojsilović, përshëndeti Ministrin dhe të pranishmit, tutej theksoi se nuk do të ndërlihen me rastin e javës së kaluar ku ka pasur disa incidente, pasi nuk i ka ndodhur asgjë askujt, pasi kemi qenë më të befashuar më vizitën e realizuar por është e ndërlihur me situatën që jemi aktualisht. Tutje theksoi se nuk e dinë a janë të informuar edhe anëtarët, që Ministri i financave ka qenë prezent në këtë vizitë dhe kjo ndoshta një shenjë që do të ketë më shumë buxhet në vitin e ardhshëm. Po ashtu e konsideroi të pa nevojshme prezencën e njësisve speciale në qendrën ekologjike, pasi kjo qendër nuk i ka shkakuar askujt rrezik. Po ashtu theksoi se sa i përket një çështje tjetër nuk e dinë a është e vërtetë nëse ka dështuar një operacion test në Kryeministri. Tutje pyeti ministrin. A ka ndodhur kjo gjë apo jo? Pasi nuk kanë marrë njoftim për një pjesëtar të komunitetit serb që i është pjesë e kësaj njësie. A është e rëndomtë vjedhja e bagëtive? Pasi aq shpesh ka ndodhur sa që askush nuk po merret me këtë fenomen. Duke mos e përmendur vetëm komunitetin serb por për të gjithë qytetarët, theksoi e ka fshatra që janë të vogla dhe mundësia për kapjen e hajrave është e mirë por nuk kapen. Si ndjeheni si Ministër kur policia nuk i zgjedh këto raste?

Bejtush Gashi-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, theksoi se objektet e rëndësisë së veçantë, kohë pas kohe testohen nga ekipet profesionale, po ashtu vërehet se ka rënë niveli I përgjegjësisë nga ana e zyrtarëve përgjegjës për të garantuar sigurinë, merren masa të drejtpërdrejta ndaj zyrtarëve. Ndërsa sa i përket çështjes së vjedhjeve janë shumë të shpeshta, rezultatet nuk janë të kënaqshme. Duke iu referuar pjesës së Suharekës, Kamenicës, Karaçevës, ka qenë i shprehur më shumë aktiviteti kriminal i vjedhjes, është shtuar bashkëpunimi me komunitetin me qëllim të uljes së këtij aktiviteti kriminal. Fenomeni I tillë ka ndodhur por është në rënie vitet e fundit.

Zoran Mojsilović, lidhur me operacionin e zhvilluar nga ana e policisë për të testuar situatën e sigurisë shtroi pyetjen. Pse janë sanksionuar disa polic, përderisa disa prej tyre kanë qenë në pushim? Po ashtu theksoi se posedon informacion se zyrtari policor ka qenë në pushim vjetor. Zharko Ivanović është zyrtari policor i cili ka qenë në pushim dhe i njëjti është transferuar.

Ministri, theksoi se sa i përket rastit konkret nuk mund të komentoj, por është detyrë e policisë të bëjë lëvizjet e caktuara dhe është autoritet i policisë të reagoj sipas specifikave dhe rasteve operationale nuk mund të komentohen me detaje.

Zoran Mojsilović, falënderoi Ministrin për raportimi me kërkesën që të vazhdohet të punohet në Ministri

Kryetari, shtroi pyetjet si në vijim. Si është duke shkuar procesi i rekrutimit në Policinë e Kosovës? Çfarë nënkuptojnë reformat në Policinë e Kosovës?

Bejtush Gashi-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në përgjigjeje të këtyre pyetjeve, theksoi e testi me shkrim ka përfunduar për kandidatë për zyrtar policor dhe fazat e tjera janë në proces. Në bazë të raporteve që posedon theksoi se është procedurë dhe autonomi e pavarur e komisioneve përgjegjëse deh se ky proces është duke u zhvilluar sipas standardeve. Ndërsa sa i përket reformave, theksi se do të fillohet në muajt në vijim një vlerësim i përgjithshëm i policisë, në mënyrë që të përshtate dinamika në raport me përgjegjësinë. Policia nga themelimi, nuk është se ka pasur ndonjë vlerësim për veten e saj, ndërsa përgjegjësit janë rritë dhe për këtë proces ka edhe përkrahje ndërkombëtare siç është ICITAP dhe për këtë arsye kërkoi edhe përkrahjen e Komisionit.

Kryetari, fjalën ia kaloi z.Rexhep Selimi-kryesues i grupit punues për mbikëqyrjen e Ligjit të IPK-së.

Rexhep Selimi, si kryesues i grupit punues për mbikëqyrjen e ligjit të IPK-së, theksoi se grupi punues vazhdon punë e tij për mbikëqyrjen e këtij ligji dhe kjo është bërë me shkasë siç ka qenë procesi i rekrutimit të disa kandidatëve për të qenë pjesë e IPK-së. Tutje shtroi pyetje për Ministrin. Pse nuk janë trajtuar njëjtë ish-Kryeshefi i IPK-së dhe Kryeshefja aktuale që atëkohë ishte ushtruese e detyrës?

Bejtush Gashi-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, theksoi se emërimi i Kryeshefes së re të IPK-së ka shkuar sipas bazës ligjore dhe është emëruar znj.Miradije Kelmendi. Ndërsa sa i përket shkarkimit, theksoi se duke e parë vendimin e Gjykatës së Apelit, theksohet që gjykata e ka cilësua si të jashtëligjshëm ndërhyrjen ministrit në Proces pro jo procesin dhe sugjeroi që të lexohet vendimi i gjykatës. Tutje shtoi që në bazë të këtij vendimi ka vepruar dhe janë në pritje të vendimit të Gjykatës Supreme për rastin konkret. Po ashtu theksoi se nën autoritetin e tij ka vlerësuar se ish-Kryeshefi ka bërë shkelje dhe ka marrë vendimin për heqjen e tij. Kryeshefja pas kalimit të afatit shatë ditor e ka zbatuar vendimin e gjykatës themelore dhe për të gjitha aplikantët ka marrë vendim që të vazhdohet procesi.

Rexhep Selimi, duke iu referuar deklaratës së ministrit që ish-Kryeshefi ka lënduar integritetin profesional të institucionit ku ka qenë. Si mundet që i njëjti person të rikthehet në policinë e Kosovës?

Fatmir Xhelili, shtroi pyetjen si në vijim. Do të ndërmerren hapa në të ardhmen që në parime dhe në procedura në kuadër të policisë, për ruajtjen ose mos ruajtjen e vendeve të punës në drejtim të ndryshimit të organizatës?

Bejtush Gashi-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, theksoi se sa i përket praktikës së deritanishme, nuk është i sigurt se ku është norma që kanë ruajtur vendin e punës, kjo mundësi do të hiqet dhe rregullorja që parasheh këtë të drejtë do të ndryshohet dhe në të ardhmen nuk do të ketë mundësi që të zbatohet një praktikë e tillë, pasi në rastet kur zyrtari policor shkon me qëllim të avancimit të organizatës jashtë vendit mund ti ruhet, por jo nëse lëviz brenda institucionit. Po ashtu theksoi se ka raste të shumta. Në përgjigjeje të pyetjes së z.Selimi, theksoi se aktualisht janë duke u bërë disa vlerësime nga menaxhmenti sa i përket çështjes së ngritur. Po ashtu theksoi se ish-kryeshefi duke mos përmbushur përgjegjësit e ka lënduar institucionin, por ka dallime të mëdha pasi përgjegjësia e tij nuk i ka përmbushur nevojat e institucionit.

Rexhep Selimi, theksoi se janë përdorur standard të dyfishta, në rastin e emërimit të znj.Kelmendi dhe trajtimit të z.Hilmi Mehmeti, ish-Kryeshef.

Fatmir Xhelili, theksoi se sa i përket grupit të parë të policëve që janë transferuar në IPK, kjo ka qenë me marrëveshje, pasi kanë nënshkruar që japin dorëheqje pa të drejtë rikthimin në polici. Në rastin e Kryeshefit të IPK-së, pse i është ruajtur vendi i punës? Ndërsa sa i përket përmendjes së lëndimit që i është bërë nga ana e Kryeshefit shtroi pyetjen. Lëndimi ka qenë nga ana menaxheriale apo nga ana ligjore?

Bejtush Gashi-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në përgjigjeje të pyetjes së z.Xhelili, theksoi se ka qenë paaftësia menaxheriale për të drejtuar institucioni dhe për efekt ka prodhuara një imazh jo të mirë të menaxhimit institucional.

Fatmir Xhelili, kjo do të thotë që ish-Kryeshefi nuk e ka shkelur ligjin?

Bejtush Gashi-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, theksoi se janë në pritje të vendimit të Gjykatës Supreme, ndërsa në disa procese ka pasur kapërcime, por vendimi nga ana e tij për shkarkimin e ish-kryeshefit, nuk ka ardhur vetëm për procesin e rekrutimit por edhe për menaxhimin dhe përgjegjësit për institucionin që ka drejtuar.

Ismet Beqiri, theksoi se nuk është pajtuar me trajtimin e çështjes që i është bërë, pasi secili deputet e ka obligim luftimin e shkeljes së ligjit dhe respektimin e vendimit të gjykatës. Po ashtu theksoi se janë duke u përdorur standarde të dyfishta, pas ka raste që pavarësisht vendimit të gjykatës, nuk merren masa për shkarkime nga detyra për rast të tjera. Tutje theksoi se kjo nuk është zbatim i ligjit dhe për këtë nuk është pajtuar edhe me anëtarët e grupit punues, pasi ende pa u dhënë vendimi i gjykatës supreme është marrë vendimi. Për vendimin e marrë për shkarkimin e ish-kryeshefit e vlerësoi si padrejtësi nëse gjykata nuk ka konstatuar që ka bërë shkelje.

Rexhep Selimi, theksoi se Komisioni nuk mund të bëjë vlerësime për performancën por vetëm për zbatimin e ligjit dhe procedurës. Tutje theksoi se sipas kritereve është dashur që kandidati të ketë përvojë të lartë menaxheriale. Tutje shtroi pyetjet. Kandidatja e emëruar çfarë pozita të larta menaxheriale ka ushtruar në krahasim me kandidatët të tjerë ? Pasi shikuar në Ligjin për shërbyesit civil, pozita të larta menaxheriale janë pozitat e Drejtorit, Sekretarit të Përgjithshëm. Ministri, në përgjigjeje të pyetjes së z.Selimi, theksoi se i ka besuar Komisionit përzgjedhës në procesin e përzgjedhjes. Tutje theksoi se kanë aplikuar gjashtëmbëdhjetë kandidatë, ndërsa janë eliminuar kandidatët të cilët nuk i kanë përmbushur kushtet dhe procesi ka qenë transparent dhe i monitoruar nga EULEX dhe ICITAP.

Rexhep Selimi, shtoi se duke e ditur Ministri që është grupi punues për mbikëqyrjen e Ligjit të IPK-së, pse nuk është pritur raporti I grupit punues dhe më pas të përzgjidhet personi i duhur. Gjithashtu njoftoi se në kutin e tij si deputet, ka ardhur një ankesë e një kandidati i cili është eliminuar nga procesi, kandidati është z.Skender Hoti. Cilat kritere nuk i ka plotësuar z.Hoti e të cilat kritere i ka plotësuar znj.Kelmendi?

Bejtush Gashi-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, theksoi që sipas Ligjit të IPK-së dhe udhëzimit administrative 33/2010, znj.Kemedni i ka përmbushur kriteret për të qenë Kryeshefe e IPK-së dhe ka përvojë në udhëheqjen e një departamenti në kuadër të IPK-së. Po ashtu theksoi se komisioni ka pasur autonomi të plotë për përzgjedhjen e kandidatëve dhe nga raporti që ka marrë me tre emra, të gjitha kanë plotësuar kushtet por është përcaktuar për znj.Kelmendi.

Ismet Beqiri, theksoi se Komisioni nuk duhet të përzihet në procese të cilat zhvillohen në kuadër të institucionit.

Daut Haradinaj, theksoi se Komisioni përzgjedhës ka vepruar sipas rregullave. Ndërsa sa i përket rolit të Komisionit theksoi se ka rol për të mbikëqyrur ligjin dhe nuk mund të marrë përgjegjësi shtesë. Ndërsa duke iu referuar kandidatëve, theksoi se shumë prej tyre mund ti kenë plotësuar kushtet por një është dashur të përzgjidhet. Po ashtu theksoi se shkarkimi i Kryeshefit të IPK-së, duhet të jetë transparent dhe të thuhet arsyeja e shkarkimit. Po ashtu përmendi edhe rastin e shkollimit të disa zyrtarëve policor jashtë vendit, shkollim i cili i ka kushtuar buxhetit të shtetit, por pasi janë kthyer vetëm dy prej tyre janë sistemuar ndërsa të tjerët kanë mbetur rrugëve. Për këtë arsye kërkoi që dikush duhet të jap sqarim për këtë.

Fatmir Xhelili, theksoi se pyetjet shtruar nga z.Selimi a janë adekuate, pasi është duke u folur për parime dhe procedura dhe jo për individ. Tutje shtroi pyetjet. A është vërejtur se cilat udhëzime administrative nuk janë në përputhje me ligjin e IPK-së? A është formuar grupi punues për përmirësimin e udhëzimeve administrative, apo priten edhe rekomandimet e grupit punues nga Kuvendi? Po ashtu theksoi se rekomandimet e grupit punues janë me vend.

A do të jetë IPK-ja një strukturë e mbyllur dhe kuadrat të vijën vetëm nga brenda, apo do të jetë strukturë e hapur që kuadrat mund të vinë edhe nga jashtë? Mënyra e përzgjedhjes së menaxherëve të dorës së dytë në IPK, a do të jetë e mbyllur apo e hapur? Sa është duke u përdorur IPK-ja për inspektimin disa fenomeneve që kanë qenë evidente kohëve të fundit në polici dhe kanë perceptim negative për policinë?

Bejtush Gashi-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në përgjigjeje të pyetjeve të deputetëve theksoi se sa i përket procesit të rekrutimit nuk dëshiron të bëjë komente pasi është në fazën e pritjes së vendimit nga gjykata supreme, ndërsa sa i përket nevojave për plotësim ndryshime, theksoi se do të bëhet fillimisht ndryshim-plotësimi i ligjit të IPK-së dhe më pas do të ndryshohen edhe udhëzimet administrative në fushat konkrete, pasi është ardhur në vlerësimin se ligji aktual dihet të ndryshohet. Konkursët në IPK janë të hapura ndërsa në të kaluarën janë bërë transfere për shkak të nevojës, por që në vijim do të ketë konkurse të hapura për pranimin e inspektorëve të rinj. Aktualisht IPK-ja trajton të gjitha rastet për të cilat ka dyshime dhe se me rekomandimin e IPK-së, policia ka marrë vendimin për një zyrtar policor I cili ka bërë shkelje dhe dy zyrtar civil.

Rexhep Selimi, theksoi se pyetjet e bëra kanë qenë në funksion të grupit punues dhe ka bërë kujdes që mos të jep vlerësim për asnjë kandidat por për procesin e zbatimit të ligjit. Pas përfundimit të raportit nga grupi punues të cilat do të dërgohen në seance, rekomandimet do të votohen nga Kuvendi dhe këto rekomandime duhet të jenë obligative. Ministri, theksoi se kërkon bashkëpunimin e Komisionit dhe se rekomandimet brenda mundësive ligjore do të zbatohen.

Kryetari, falënderoi për raportimin e Ministrit me këtë pikë të rendit të ditës, e konsideroi takimin e mbyllur për këtë sesion.

Mbledhja përfundoi në orën 11:35.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Haxhi Shala